



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
*Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister*

Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance

*Raporti vjetor për konsultime publike në Qeverinë e Republikës së Kosovës për vitin 2023*



Mars 2024

## **Përmbajtja**

|   |           |
|---|-----------|
| <b>1. Hyrje</b> .....   | <b>6</b>  |
| <b>2. Përmbledhje Ekzekutive</b> .....  | <b>8</b>  |
| <b>3. Metodologjia e raportimit dhe monitorimit të zbatimit të standardeve</b> .....  | <b>10</b> |
| <b>4. Platforma online për konsultimet publike/ <a href="https://konsultimet.rks-gov.net/">https://konsultimet.rks-gov.net/</a></b> ..... | <b>14</b> |
| <b>5. Ngritja e kapaciteteve për zyrtarët publik për konsultimet me publikun dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile</b> .....              | <b>14</b> |
| <b>6. Shkalla e plotësimit të standardeve minimale</b> .....  | <b>15</b> |
| <b>7. Metodatat e përdorura gjatë procesit të konsultimeve</b> .....  | <b>17</b> |
| <b>8. Numri dhe statusi i komenteve</b> .....   | <b>17</b> |
| <b>9. Përmbledhje për procesin e konsultimeve gjatë viti 2023</b> .....   | <b>19</b> |
| <b>10. Sfidat e vitit 2023 dhe rekomandimet</b> .....   | <b>20</b> |
| <b>11. Numri i përgjithshëm i projekt dokumenteve</b> .....   | <b>21</b> |
| <b>SHTOJCA I: Numri i përgjithshëm i projekt dokumenteve (Lista e dokumenteve të konsultuara gjatë vitit 2023)</b> .....                  | <b>22</b> |
| <b>SHTOJCA II: Lista e dokumenteve të publikuara sipas regjistrimit të platformës prej 01.01.2023-31.12.2023</b> .....                    | <b>71</b> |

## **Lista e Figurave**

Figura 1: Përmbledhje e llojit të dokumenteve për konsultat e hapur gjatë periudhës-Data:01.01.2023- 31.12.2023

Figura 2: Paraqitja grafike e statistikave sipas institucioneve qendrore në vitin 2023

Figura 3: Përmbledhje e llojit të dokumenteve për konsultat e mbyllura gjatë periudhës -Data: 01.01.2023 - 31.12.2023

Figura 4: Shkalla e plotësimit të standardeve minimale për dokumentet e publikuara sipas institucioneve për vitin 2023

Figura 5: Përmbledhja e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas aktivitetit të bashkëpunëtoreve (2023)

## **Lista e Tabelave**

Tabela 1: Përmbledhje e llojit të dokumenteve për konsultat e hapura gjatë periudhës-Data:01.01.2023-31.12.2023.

Tabela 2: Numri i dokumenteve të konsultuara gjatë vitit 2023 për të cilat konsultimi është mbyllur .

Tabela3: Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas publikimit të raporteve finale Data: 01.01.2023-31.12.2023.

Tabela4:Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas aktivitetit të bashkëpunëtoreve .

## **Lista e shkurtesave**

1. ZKM Zyra e Kryeministrit
2. ZQM Zyra për Qeverisje të Mirë
3. MAPL Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
4. MASHT Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
5. MBPZHR Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
6. MD Ministria e Drejtësisë
7. MFPT Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
8. MM Ministria e Mbrojtjes
9. MINT Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
10. MKRS Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve
11. MPB Ministria e Punëve të Brendshme
12. MPJD Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
13. MSH Ministria e Shëndetësisë
14. MMPHI Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
15. ME Ministria e Ekonomisë
16. MZHR Ministria e Zhvillimit Rajonal
17. MKK Ministria për Kthimit dhe Komuniteteve
18. KE Komisioni Evropian

Të nderuar/a,

Jemi të privilegjuar që e kemi mundësinë për të raportuar për progresin, rezultatet dhe sfidat e vitit të kaluar në lidhje me konsultimet me publikun për institucionet dhe qeverinë e vendit tonë. Raporti vjetor për konsultimet me publikun e shpreh përkushtimin tonë për transparencë, përgjegjësi dhe pjesëmarrje të qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Tashmë, këto rezultate dhe suksese vijnë falë punës dhe përkushtimit të Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit dhe koordinatorëve për konsultimet me publikun në secilën ministri dhe komunë. Kjo është realizuar veçanërisht përmes përdorimit të platformës për konsultime me publikun <https://konsultimet.rks-gov.net/> dhe rrjeteve të tjera sociale që po e lehtësojnë komunikimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes dhe politikave konsultative. Gjithashtu, me punën dhe përkushtimin tonë të vazhdueshëm në organizimin e takimeve publike të rregullta, konsultimeve të hapura për dëgjimin dhe marrjen e kontributeve dhe komenteve nga opinioni publik. Kjo, me synim dhe fokus në ndërtimin e një atmosfere besimi dhe respekti ndaj mendimeve të qytetarëve, duke i trajtuar ata si partnerë në formimin e politikave dhe vendimmarrjes. Përmes këtyre praktikave, institucionet kanë arritur të përfshijnë në mënyrë efektive qytetarët në proceset e vendimmarrjes dhe politikave, duke siguruar një mjedis më të hapur dhe më gjithëpërfshirës për të gjithë.

Zhvillimi i programeve të edukimit për institucionet dhe qytetarët për të rritur ndërgjegjësimin dhe aftësinë e tyre për të marrë pjesë në proceset politike po vazhdon të sigurohet në bashkëpunim nga institucionet dhe organizatat e shoqërisë civile, si dhe me partnerë dhe bashkëpunëtorë të tjerë. Gjithashtu, monitorimi dhe vlerësimi i efektivitetit të konsultimeve po vazhdon për të siguruar përmirësime të vazhdueshme në proceset e përfshirjes së publikut në bërjen e politikave dhe vendimmarrjes. Kjo punë po bëhet në mënyrë të vazhdueshme, edhe nga organizatat jo-qeveritare, duke na shtyrë në punën tonë të përditshme.

Ne do të vazhdojmë të jemi të fokusuar në rritjen e besimit të qytetarëve te institucionet tona. Ju sigurojmë se edhe përkundër sfidave, pjesëmarrja e publikut në bërjen e politikave dhe konsultime do të mbetet thelbësore për të ndërtuar një shoqëri më të drejtë dhe më të përfshirë. Megjithatë, nevoja për investime të mëtejshme në teknologji dhe infrastrukturë për të siguruar qasje të barabartë për të gjithë qytetarët në proceset e përfshirjes së publikut në politikë bërje është dhe do të mbetet një prioritet në planet tona.

Të dashur kolegë dhe miq, në këtë raport do të gjeni një pasqyrë të qartë mbi arritjet, sukseset, pengesat dhe sfidat tona që i kemi përpara.

Me respekt,  
Habit Hajredini

## 1. Hyrje

Niveli i bashkëpunimit midis institucioneve qeveritare dhe shoqërisë civile është një ndër treguesit kryesorë dhe parimet themelore për një qeverisje të mirë, transparente, të përfshirë dhe llogaridhënëse. Qeveria e Republikës së Kosovës ka bërë progres në zhvillimin e standardeve dhe praktikave për të rritur pjesëmarrjen e shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe legjislacionit, veçanërisht me zbatimin e Rregullores për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit me Publikun (Nr. 05/2016). Pjesëmarrja e jashtëzakonshme e shoqërisë civile në vendimmarrjen politike dhe progresi i theksuar është evidentuar nëpërmjet Platformës Online për Konsultime me Publikun <https://konsultimet.rks-gov.net/>, ku palët e interesuara, shoqëria civile dhe publiku i gjerë janë regjistruar dhe kanë dhënë kontributin e tyre duke ofruar komente dhe duke marrë pjesë në hartimin e politikave dhe legjislacionit.

Shoqëria civile vazhdon të jetë një partner kyç në procesin e përgatitjes së Kosovës për anëtarësimin në Bashkimin Evropian (BE), duke kontribuar në formulimin, implementimin dhe vëzhgimin e reformave të lidhura me BE-në dhe duke u përfshirë në platformat e dialogut të politikave të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Është e rëndësishme të theksohet se sipas Raportit të Komisionit Evropian për vitin 2023, shoqëria civile në Republikën e Kosovës operon në një mjedis në përgjithësi të favorshëm. Ky raport nënvizon gjithashtu angazhimin aktiv të shoqërisë civile në konsultimet publike dhe kontributin e tyre në proceset e politikave dhe në monitorimin e procesit të konsultimeve. Sipas raportit, përpjekjet e autoriteteve publike për të angazhuar qytetarët në proceset vendimmarrëse janë të mirëpritura dhe duhet të forcohen dhe të vazhdojnë në të ardhmen. Prandaj, bashkëpunimi ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile në formësimin dhe zbatimin e politikave publike është esencial për zhvillimin e një qeverisjeje gjithëpërfshirëse, të orientuar ndaj qytetarit dhe për respektimin e diversitetit në të gjitha aspektet e shoqërisë.

Udhëzuesi për Mbështetjen e BE-së për Shoqërinë Civile në Rajonin e Zgjerimit 2021-2027, si dhe parimet e miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerimin e BE-së, theksojnë rëndësinë e caktimit të objektivave të qarta, rezultateve dhe treguesve për monitorimin e progresit të qeverive në këtë fushë. Këto elemente janë të integruara si pjesë të rëndësishme të kriterëve politike dhe reflektohen rregullisht në raportet vjetore mbi progresin e Kosovës. Zhvillimi i shoqërisë civile dhe demokratizimi janë përfshirë si elemente kyçe në "Parimet e OECD/SIGMA për Administratën Publike", të cilat udhëzojnë administratat e rajoneve të zgjerimit dhe fqinjësisë së BE-së në përpjekjet e tyre reformuese për të adresuar mangësitë në administratën publike dhe për të plotësuar kërkesat e BE-së për një nga 'shtyllat' e procesit të anëtarësimit.

Vlerësimi i raporteve të Strategjisë për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile, nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit dhe nga Platforma CiviKos, tregon se ka pasur progres të dukshëm në përfshirjen e Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-ve) në politikë bërje dhe vendimmarrje. Progresi është veçanërisht i theksuar nga pjesëmarrja e tyre në grupet punuese gjatë hartimit të dokumenteve publike dhe deri në përfundimin e procesit të konsultimeve publike. Është

vërejtur një rritje e konsiderueshme e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në proceset e politikë bërjes, dhe ky progres është më i dukshëm kur palët e interesuara nga shoqëria civile dhe publiku i gjerë janë të angazhuar dhe kontribuojnë aktivisht. Platforma ofron një mjedis ku publiku dhe OJQ-të kanë mundësi të angazhohen, të informohen dhe të japin kontributin e tyre përmes komenteve dhe rekomandimeve në lidhje me politikën dhe legjislativën që po zhvillohet nga institucionet publike.

Po ashtu, ka pasur arritje në realizimin e synimeve përmes aktiviteteve të organizuara për të rritur kapacitetet, si trajnimet dhe monitorimet për nëpunësit. Është bërë përmirësim i qasjes në platformë për personat me aftësi të kufizuara dhe është zgjeruar spektri i komponentëve të sistemit të konsultimit në nivelin lokal të qeverisjes. Në përgjithësi, publikimi i dokumenteve për konsultim publik konsiderohet të jetë në një nivel të kënaqshëm, me një shkallë të plotësimit formal të standardeve minimale prej 77% për vitin 2022. Megjithatë, viti 2023 ka regjistruar një rënie të lehtë në plotësimin e këtyre standardeve minimale të konsultimeve me publikun.

Mirëpo, përfshirja e kontributeve që dalin nga procesi i konsultimeve në dokumentet e konsultuara dhe ndikimi i tyre në përmirësimin e këtyre dokumenteve, paraqet ende një sfidë dhe nuk merren parasysh në mënyrë sistematike. Prandaj, përpjekjet e institucioneve publike për të përfshirë publikun dhe organizatat jo-qeveritare në proceset e politikës duhet të vazhdojnë dhe të rriten edhe më tej. Përmes Strategjisë për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile, Qeveria e Republikës së Kosovës ka shprehur vullnetin e saj politik dhe angazhimin për të ndërmarrë hapa të mëtejshëm drejt përmirësimit të ambientit të pjesëmarrjes së shoqërisë civile, veçanërisht Organizatave të Shoqërisë Civile, në proceset e politikës dhe vendimmarrjes qeveritare.

Qeveria ka miratuar politika dhe mekanizma për rregullimin dhe avancimin e sistemit të mbështetjes së sektorit të shoqërisë civile nga ana e qeverisë, duke ofruar mundësi për Organizatat e Shoqërisë Civile për të dhënë kontributin e tyre.

Pra, dokumenti kyç që përcakton kornizën e bashkëpunimit në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Shoqërisë Civile është Strategjia për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile. Përmes kësaj strategjie, Qeveria e Republikës së Kosovës ka përcaktuar objektiva strategjike dhe masat për përmirësimin e mjedisit përkrahës në zhvillimin e shoqërisë civile. Ndërsa mekanizmi i Këshillit për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile, i themeluar në vitin 2019 nga Qeveria, ka luajtur një rol të rëndësishëm në monitorimin e zbatimit të politikave dhe aktiviteteve të planifikuara me Strategjinë, si dhe në përkrahjen e proceseve për koordinimin e bashkëpunimit midis Qeverisë dhe shoqërisë civile. Në të njëjtën kohë, Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit ka luajtur një rol të rëndësishëm në procesin e raportimeve të rregullta mbi zbatimin e Strategjisë dhe Planit të veprimit të saj. Si rezultat, monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe shqyrtimi i raporteve të monitorimit bëhet në baza të rregullta nga ana e Këshillit.

Zyra e Qeverisjes së Mirë/Zyra e Kryeministrit, si udhëheqëse e të gjithë procesit të bashkëpunimit të qeverisë me shoqërinë civile, në mars 2024 nga Sekretari i Përgjithshëm dhe Platforma CiviKos ka

marrë aprovimin për krijimin e ekipit të punës për hartimin e Strategjisë së Re për bashkëpunim me Shoqërinë Civile për periudhën 2024-2030.

Sistemi aktual i konsultimeve publike në Republikën e Kosovës ka arritur një fazë të avancuar, e cila vërehet në përmirësimin dhe stabilizimin e procesit të krijimit të politikave dhe hartimit të legjislacionit. Ky proces drejtohet dhe koordinohet nga Zyra për Qeverisje të Mirë, e cila operon nën ombrellën e Zyrës së Kryeministrit, dhe mbështetet nga koordinatorët për konsultime me publikun në të njëjtën zyrë, si dhe nga ata në Ministrinë e Linjës, për të shtrirë veprimtarinë edhe te koordinatorët në nivelin lokal - në komunitet e Kosovës. Si rezultat, plotësimi i standardeve tashmë është integruar në punën e përditshme të institucioneve qeveritare, përfshirë ato lokale.

Gjatë vitit 2023, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit ka bërë përparime në përmirësimin e platformës për konsultime (<https://konsultimet.rks-gov.net>), duke synuar të rrisë qëndrueshmërinë dhe stabilitetin e sistemit të konsultimeve publike dhe, më e rëndësishmja, të forcojë përfshirjen e shoqërisë civile në procesin e krijimit të politikave dhe të vendimmarrjes. Kjo platformë është zhvilluar me shtim të funksionaliteteve të reja dhe përmirësim të qasjes për qytetarët dhe shoqërinë civile, të cilët tani kanë mundësi më të mira për të marrë pjesë në proceset konsultative.

Me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit ka punuar gjithashtu për të përmirësuar qasjen e platformës për njerëzit me aftësi të kufizuara. Përpjekjet përfshijnë veçanërisht përmirësimin e qasjes për personat e shurdhër dhe ato të verbër, duke u mundësuar atyre të kontribuojnë në formimin e politikave dhe legjislacionit. Ky proces gjithëpërfshirës garanton se të gjithë qytetarët, pa përjashtim, kanë mundësi të marrin pjesë aktivisht dhe të japin kontributin e tyre për të mirën e përgjithshme.

## **2. Përmbledhje Ekzekutive**

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, në përputhje me Rregulloren nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Konsultimet me Publikun, udhëheqë dhe është përgjegjëse për të gjithë procesin e koordinimit të konsultimeve publike në platformë. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, në bashkëpunim me koordinatorët për konsultime në të gjitha ministritë dhe institucionet tjera të përfshira në procesin e zhvillimit të politikave dhe legjislacionit, edhe këtë vit ka përgatitur raportin vjetor për vitin 2023 për konsultimet me publikun.

Raporti vjetor për vitin 2023 përfshin të gjitha dokumentet që janë publikuar në platformën për konsultimet me publikun dhe për të cilat konsultimi ka filluar nga data 01.01.2023 dhe është mbyllur më datë 31.12.2023 nga Zyra e Kryeministrit dhe Ministrinë. Raporti ka për qëllim të paraqesë punën e bërë gjatë vitit 2023 në zbatimin e standardeve minimale për procesin e konsultimeve publike nga ana e Qeverisë dhe Ministrive të Linjës.



Raporti paraqet detajet dhe statistikat për plotësimin e të gjitha standardeve, duke filluar nga planifikimi, inicimi dhe procesi i hartimit të dokumenteve, rrjedha e konsultimit, hartimi i dokumentit të konsultimit, përdorimi i metodave të konsultimit, duke përfshirë edhe platformën, pjesëmarrjen e publikut në ofrimin e kontributeve të tyre, statusin e komenteve, etj.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit si koordinatorë e procesit të konsultimeve me publikun, në bashkëpunim me të gjitha ministritë e linjës përmes koordinatorëve për konsultime në ministritë e linjës, kanë vazhduar të ofrojnë, në kapacitetet e tyre maksimale, hapësirë publikut për të përfshirë veten në procesin e konsultimit publik. Rrjedhimisht, është punuar në monitorimin dhe raportimin e procesit të konsultimeve me publikun. Megjithatë, për të inkurajuar dhe për të përmirësuar përfshirjen e shoqërisë civile, është e nevojshme që institucionet shtetërore të vazhdojnë të zgjerohen hapësirën për të siguruar prioritetin e përfshirjes së shoqërisë civile në procesin e konsultimeve publike dhe të ndërmarrin masa për të garantuar një rol edhe më të madh për ta në konsultimet publike. Kjo do të ndihmojë në rritjen e besueshmërisë dhe një respekt reciprok për rolin dhe ndikimin e njëri-tjetrit në ndërtimin e marrëdhënieve afatgjata të dobishme për të dyja palët dhe në procesin e politikës së bërjes. Gjithashtu, për të inkurajuar përfshirjen e shoqërisë civile në proceset e politikës së bërjes, institucionet publike duhet të ndërtojnë marrëdhënie të mira me shoqërinë civile dhe të trajtojnë ato si partnere aktive në dialog dhe procesin e vendimmarrjes. Kjo mund të bëhet përmes krijimit të mekanizmave të ndryshëm të konsultimit dhe bashkëpunimit, siç janë forume të hapura të diskutimit, takime të rregullta me organizatat e shoqërisë civile dhe krijimi i platformave online.

Përveç shtrirjes në nivel qendror të qeverisë, sistemi i konsultimeve publike është zgjeruar edhe në shumicën e komunave, jo vetëm në aspektin rregullator, por edhe në krijimin e mjeteve dhe kushteve për zbatimin e tij. Tani, të gjitha komunat janë pjesë e integruar e platformës për konsultimet me publikun dhe shumica kanë emëruar koordinatorë për konsultime me publikun dhe po publikojnë dokumente për t'u konsultuar dhe përfshirë publikun dhe organizatat jo-qeveritare.

Mirëpo, duhet të theksohet se niveli lokal nuk është pjesë e fushës së veprimtarisë së këtij raporti për këtë vit. Vetëm disa të dhëna të përgjithshme janë përfshirë, sepse monitorimi dhe raportimi i procesit të konsultimeve me publikun në nivel lokal është përgjegjësi e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Këtë vit, një numër shumë më i madh i komunave kanë emëruar koordinatorë për konsultimet dhe po publikojnë dokumente për konsultimet me publikun në platformën për konsultime.

Sipas statistikave të nxjerra për periudhën që po raportohet, gjatë vitit 2023 janë publikuar 244 dokumente. Në këto 244 dokumente, përfshihen: 22 koncept dokumente, 41 draft-ligje, 11 strategji, 5 programe, 4 plane veprimi, 35 draft-rregullore, 117 udhëzime administrative dhe 9 dokumente të tjera.

### **Raporti paraqet në mënyrë të detajuar kategoritë e informacionit si vijon:**

**Numri i përgjithshëm i dokumenteve të hartuara dhe të konsultuara** - Sipas statistikave të nxjerra për periudhën që po raportohet, nga 01 janari 2023 deri më 31 dhjetor 2023, janë 244 dokumente. Nga këto

dokumente, janë: 22 koncept dokumente, 40 draft-ligje, 11 strategji, 5 programe, 4 plane veprimi, 35 draft rregullore, 117 udhëzime administrative dhe 9 dokumente të tjera.

**Plotësimi i standardeve** - Dokumentet për të cilat konsultime janë hapur nga 01.01.2023 deri më 31.12.2023 janë gjithsej 244 dokumente. Nga 244 dokumentet e publikuara në platformë, 153 prej tyre kanë plotësuar standardet dhe 91 nuk i kanë plotësuar. Kjo do të thotë se 62.70% i dokumenteve plotësojnë standardet, ndërsa 37.30% nuk i plotësojnë standardet minimale për konsultime me publikun.

**Pjesëmarrja në procesin e konsultimit dhe komentet** - Raportohet se gjatë procesit të konsultimeve publike, gjithsej 2912 pjesëmarrës kanë marrë pjesë. Nga këta pjesëmarrës, janë bërë 2308 komente përmes platformës, takimeve, grupeve të punës ose shkrimit. Nga këto komente, 925 janë pranuar plotësisht, 387 pjesërisht, ndërsa 912 janë refuzuar ose nuk janë pranuar nga institucionet hartuese.

**Komentet direkt në platformën online** - Numri i komenteve që janë pranuar direkt në platformë gjatë vitit 2023, nga 01.01.2023 deri më 31.12.2023, është 162. Kjo do të thotë se nga 244 dokumentet të publikuara gjatë kësaj periudhe, janë komentuar gjithsej me 162 komente.

**Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas aktivitetit të bashkëpunëtoreve** - Nga 01.01.2023 deri më 31.12.2023, prej 244 dokumenteve të publikuara në platformë, 193 dokumente janë pa komente dhe 44 dokumente kanë 162 komente.

**Metodat e përdorura të konsultimit** - Gjatë vitit 2023, në platformën për konsultime me publikun janë publikuar 244 dokumente. Shumica e dokumenteve të konsultuara në platformë janë konsultuar edhe përmes komunikimit zyrtar, takimeve të punës, takimeve online, konsultimeve me shkrim, etj.

### **3. Metodologjia e raportimit dhe monitorimit të zbatimit të standardeve**

Edhe në vitin 2023, raportimi vjetor për rrjedhën e konsultimeve me publikun është bërë sipas metodologjisë së raportimit për rregulloren për konsultimet me publikun. Për përgatitjen e raportit janë përdorur disa burime të informacionit:

- Të gjitha të dhënat dhe informacionet e përcjella nga koordinatorët e konsultimeve publike nga secila ministri dhe Zyra e Kryeministrit.
- Të dhënat e publikuara dhe të përditësuara nga platforma për konsultimet me publikun.
- Të dhëna të tjera që rrjedhin nga aktivitetet e Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit dhe projektet që mbështesin Qeverinë në zhvillimin dhe avancimin e konsultimeve publike.

Kriteret e vlerësimit sipas Rregullores për standardet minimale janë:

- Secili dokument i konsultuar duhet të ketë planin e konsultimit.
- Dokumenti i konsultimit së bashku me dokumentin themelor, i cili konsultohet, duhet të jetë i publikuar në platformën elektronike për konsultimet publike.
- Afati i konsultimit duhet të jetë së paku 15 ditë pune, si dhe

- Raporti final i dokumentit të konsultuar dhe versioni i fundit i dokumentit duhet të publikohen bashkë me raportin final.

Kërkesës së Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit për raportim nga ana e ministrive të dërguar me datë 20 shkurt deri në mars 2023 i janë përgjigjur 14 ministri nga 15 që janë, si dhe zyrat përgjegjëse në Zyrën e Kryeministrit. Nga 15 ministri, MKK nuk ka publikuar dokumentet në platformën për konsultime dhe nuk ka përcjellë dokumente për aprovim në qeveri, ndërsa MPJD nuk ka përcjellë raport.

Të dhënat që kanë munguar nga raportet e mundshme të koordinatorëve janë marrë drejtpërdrejt nga platforma. Raportimi nga koordinatorët e nivelit qendror është bërë përmes formularëve të dizajnuar për mbledhjen e informacionit për hartimin e raportit vjetor sipas Rregullores dhe Metodologjisë së Monitorimit dhe Raportimit për zbatimin e standardeve minimale, të miratuara nga ZKM në vitin 2017.

Gjithashtu, pasi disa nga informatat e raportuara nga ministrinë nuk janë përputhur me ato që gjenden në platformë, atëherë informacionet plotësuese janë marrë nga platforma elektronike për konsultimet publike.

| Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas institucioneve - Konsultat e mbyllura gjate periudhës (që janë mbyllur gjate periudhës) - Data: 01.01.2023-31.12.2023 |                  |            |                 |                  |                         |           |         |        |        |  |
|--|------------------|------------|-----------------|------------------|-------------------------|-----------|---------|--------|--------|--|
| Institucioni / Tipi dokumentit   | Koncept dokument | Draft ligj | Plan i veprimit | Draft rregullore | Udhëzime administrative | Strategji | Program | Tjetër | Totali | Ne përqindje ne raport me të gjitha IRK-te |
| Zyra e Kryeministrit   | 0                | 0          | 0               | 6                | 6                       | 1         | 1       | 0      | 14     | 5.74%                                      |
| MKRS   | 0                | 0          | 1               | 1                | 2                       | 3         | 0       | 3      | 10     | 4.10%                                      |
| MMPHI  | 2                | 6          | 1               | 1                | 1                       | 5         | 0       | 21     | 37     | 15.16%                                     |
| MINT   | 9                | 1          | 4               | 0                | 1                       | 1         | 4       | 1      | 21     | 8.61%                                      |
| MAPL   | 4                | 0          | 1               | 0                | 0                       | 0         | 2       | 1      | 8      | 3.28%                                      |
| MM   | 0                | 2          | 0               | 0                | 0                       | 1         | 12      | 1      | 16     | 6.56%                                      |
| MFPT   | 2                | 3          | 0               | 3                | 6                       | 0         | 0       | 0      | 14     | 5.74%                                      |
| MSH  | 0                | 7          | 0               | 0                | 2                       | 1         | 1       | 2      | 13     | 5.33%                                      |
| MBPZHR   | 1                | 0          | 21              | 0                | 3                       | 0         | 0       | 0      | 25     | 10.25%                                     |
| ME   | 0                | 0          | 1               | 2                | 0                       | 0         | 1       | 0      | 4      | 1.64%                                      |

|                     |              |               |              |               |               |              |              |              |            |         |
|---------------------|--------------|---------------|--------------|---------------|---------------|--------------|--------------|--------------|------------|---------|
| MD                  | 2            | 4             | 0            | 23            | 0             | 4            | 3            | 1            | 37         | 15.16 % |
| MKK                 | 0            | 0             | 0            | 0             | 0             | 0            | 0            | 0            | 0          | 0.00%   |
| MPB                 | 5            | 6             | 8            | 0             | 3             | 0            | 1            | 1            | 24         | 9.84%   |
| MASHTI              | 1            | 0             | 0            | 1             | 2             | 1            | 15           | 0            | 20         | 8.20%   |
| MPJD                | 0            | 0             | 0            | 0             | 0             | 0            | 0            | 0            | 0          | 0.00%   |
| MZHR                | 0            | 1             | 0            | 0             | 0             | 0            | 0            | 0            | 1          | 0.41%   |
| <b>Totali</b>       | <b>22</b>    | <b>41</b>     | <b>4</b>     | <b>35</b>     | <b>117</b>    | <b>11</b>    | <b>5</b>     | <b>9</b>     | <b>244</b> |         |
| <b>Ne përqindje</b> | <b>9.02%</b> | <b>16.80%</b> | <b>1.64%</b> | <b>14.34%</b> | <b>47.95%</b> | <b>4.51%</b> | <b>2.05%</b> | <b>3.69%</b> |            |         |

Tabela 1: Përmbledhje e llojit të dokumenteve për konsultat gjatë periudhës - Data: 01.01.2023 - 31.12.2023




Figura 1. Përmbledhje e llojit të dokumenteve për konsultat gjatë periudhës - Data: 01.01.2023 - 31.12.2023

Më poshtë në figurë janë përmbledhur dhe paraqitur edhe në mënyrë grafike statistikat sipas institucioneve për dokumentet e publikuara për vitin 2023.

## Permbledhje e llojeve te dokumenteve te publikuara sipas institucionev




Figura 2. Paraqitja grafike e statistikave sipas institucioneve qendrore në vitin 2023

Krahas dokumenteve të publikuara në platformën për konsultimet me publikun, kemi edhe dokumente të nivelit lokal, pra nga Komunat. Publikimi i dokumenteve nga ana e nivelit lokal në platformë gjatë vitit 2023 ka qenë një përmirësim i jashtëzakonshëm. Gjatë këtij viti, janë publikuar shumë më shumë dokumente për konsultime me publikun në nivelin lokal në krahasim me vitin e mëparshëm.

Nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, niveli lokal ka publikuar në total 238 dokumente, duke përfshirë 13 koncept dokumente, 01 draft ligj, 11 strategji, 03 programe, 38 plane veprimi, 59 draft rregullore, dhe 113 dokumente të tjera. Megjithatë, në këtë raport, detajet statistikore për publikimin e dokumenteve dhe konsultimet publike në nivel lokal nuk janë të përfshira.

Vlen të theksohet se Komuna e Prizrenit, Komuna e Malishevës, Komuna e Prishtinës, Komuna e Mitrovicës, Komuna e Pejës, Komuna e Lipjanit, Komuna e Gjilanit, Komuna e Ferizajt, Komuna e Rahovecit, Komuna e Suharekës, Komuna e Kaçanikut, Komuna e Kamenicës, Glllogoci, Hani i Elezit, Istogu, dhe shumë të tjera kanë publikuar dokumente për konsultime me publikun gjatë vitit 2023. Megjithatë, ka rreth dhjetë komuna që nuk kanë publikuar dokumente në platformë për konsultime me publikun.

#### **4. Platforma online për konsultimet publike/<https://konsultimet.rks-gov.net/>**

Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit në platformën online për konsultimet me publikun gjatë vitit 2023 ka punuar në përditësimin e të dhënave për institucionet, si dhe për koordinatorët gjatë gjithë kohës, veçanërisht në ndryshimin e vendimeve për koordinatorët në institucionet qeveritare, korrigjimin e platformës dhe mirëmbajtjen e saj me të dhëna të reja.

Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit ka vazhduar të punojë në ndërtimin e sistemit të konsultimeve publike, duke përfshirë edhe nivelin lokal dhe për të akomoduar kërkesat për përfshirjen e komunave në procesin e konsultimit. Gjatë gjithë vitit, ka ndihmuar koordinatorët e nivelit lokal për të publikuar dokumente për konsultime në platformën online. Janë shtuar module të reja për shumicën e komunave në platformë, si dhe është ndërtuar sistemi i gjenerimit të statistikave edhe për nivelin lokal. Koordinatorët nga niveli lokal tashmë, për shumicën e tyre, janë pjesë e sistemit të administrimit të platformës për komunat e tyre dhe pjesë e përfshirjes së publikut në politikë bërjen dhe vendimmarrjen.

Gjatë kësaj kohe, kemi qëndruar të fokusuar në zbatimin e standardeve minimale për konsultimet me publikun dhe kemi arritur të avancojmë Platformën e Konsultimeve Publike <https://konsultimet.rks-gov.net>, duke shtuar funksionalitete të reja dhe duke përmirësuar qasjen për qytetarët dhe shoqërinë civile për pjesëmarrje në proceset konsultative në lidhje me dokumentet që hartohen nga institucionet qendrore dhe lokale. Kemi ofruar një pasqyrë të qartë të performancës së institucioneve në përfshirjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile në politikë bërje.

#### **5. Ngritja e kapaciteteve për zyrtarët publik për konsultimet me publikun dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile**

Me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të qasjes dhe koordinimit ndër-institucional për procesin e konsultimit, si dhe të platformës online për konsultime me publikun, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, me mbështetjen e OSBE-së, ka publikuar "Kornizën për përmirësimin e zbatimit të standardeve minimale për konsultimet me publikun për periudhën 2021 – 2025". Pas lansimit të kësaj kornize, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit ka nisur zbatimin e rekomandimeve që kanë dalë nga ajo, me synimin që institucionet të përmirësojnë zbatimin e standardeve minimale për një përfshirje më të gjerë të publikut në punën e tyre.

ZQM/ZKM, në bashkëpunim me OSBE-në në Kosovë, ka punuar në përmirësimin e funksionimit të përgjithshëm të Platformës Online për konsultime me publikun, veçanërisht duke e zbatuar një nga rekomandimet që synojnë përmirësimin e qasjes për personat me aftësi të kufizuara në këtë platformë. Ky përditësim dhe avancim i platformës u mundëson personave të shurdhër dhe atyre të verbër të qasën dhe të kontribuojnë në formimin e politikave dhe legjislacionit. Qasja e përmirësuar në platformë u lejon personave me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në mënyrë aktive në proceset shoqërore në Kosovë dhe të japin kontributin e tyre në zhvillimin e politikave.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur si prioritet forcimin e bashkëpunimit me organizatat joqeveritare, forumet, koalicionet e OJQ-ve dhe ato që punojnë ngushtë me grupe të ndjeshme të shoqërisë. Struktura kyçe e këtij bashkëpunimi janë Këshilli për Bashkëpunimin e Qeverisë me Shoqërinë Civile, Koalicioni për Mbrojtjen e Fëmijëve, Forumi i Personave me Aftësi të Kufizuara, Rrjeti i Grupeve të Grave, etj. Gjithashtu, ka një pjesëmarrje dhe përfaqësim të shtuar të shoqërisë civile në mekanizmat institucionalë në fusha të ndryshme të veprimtimit.

Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve publik për konsultime me publikun, përmes Institutit të Kosovës për Administratë Publike (IKAP) dhe në bashkëpunim me ekipin e trajnerëve të certifikuar dhe ZQM/ZKM, ka vazhduar me trajnime të ndryshme, të organizuara si në grupe ashtu edhe në zyrat dhe institucionet përgjegjëse për konsultimet publike.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit po vazhdon me fushatën informuese për Platformën për konsultime me publikun. Udhëzuesi dhe video materiale promovuese për përdorimin e Platformës Online për Konsultime Publike po ndahen jo vetëm përmes platformës, por edhe në rrjetet sociale dhe në publikime të ndryshme në portalet ditore.


## 6. Shkalla e plotësimit të standardeve minimale

Të 244 dokumentet e publikuara në platformë, janë dokumente për të cilat konsultimi publik është mbyllur më 31/12/2023. Plotësimi i standardeve minimale të konsultimeve publike për këto dokumente është si vijon: 153 dokumente i kanë plotësuar standardet ndërsa 91 nuk i kanë plotësuar. Shprehur në përqindje, kjo do të thotë se 62,70% e dokumenteve i plotësojnë standardet ndërsa 37,30% prej tyre nuk i plotësojnë standardet minimale për konsultime me publikun.

| <b>Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas publikimit të raporteve finale</b> |                        |                        |               |   |
|--|------------------------|------------------------|---------------|---|
| <b>- Data: 01.01.2023-31.12.2023</b>   |                        |                        |               |   |
| <b>Institucioni</b>  | <b>Me raport final</b> | <b>Pa raport final</b> | <b>Totali</b> | <b>Ne përqindje ne raportin (Me raport / Pa raport)</b> |
| MMPH   | 20                     | 17                     | 37            | 54.05%  |
| MINT   | 20                     | 1                      | 21            | 95.24%  |
| MASHTI   | 19                     | 1                      | 20            | 95.00%  |

|                      |               |               |            |         |
|----------------------|---------------|---------------|------------|---------|
| MM                   | 16            | 0             | 16         | 100.00% |
| MD                   | 16            | 21            | 37         | 43.24%  |
| MBPZHR               | 14            | 11            | 25         | 56.00%  |
| MKRS                 | 10            | 0             | 10         | 100.00% |
| MPB                  | 10            | 14            | 24         | 41.67%  |
| Zyra e Kryeministrit | 9             | 5             | 14         | 64.29%  |
| MFPT                 | 9             | 5             | 14         | 64.29%  |
| MPAPL                | 8             | 0             | 8          | 100.00% |
| ME                   | 2             | 2             | 4          | 50.00%  |
| MZHR                 | 0             | 1             | 1          | 0.00%   |
| MSH                  | 0             | 13            | 13         | 0.00%   |
| <b>Totali</b>        | <b>153</b>    | <b>91</b>     | <b>244</b> |         |
| <b>Ne përqindje</b>  | <b>62.70%</b> | <b>37.30%</b> |            |         |

*Tabela 3: Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas publikimit të raporteve finale - Data: 01.01.2023-31.12.2023*



*Figura 4: Shkalla e plotësimit të standardeve minimale për dokumentet e publikuara sipas institucioneve për vitin 2023*



Ministritë që i kanë plotësuar standardet plotësisht janë: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Ministria e Mbrojtjes; Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal; Ministria e Zhvillimit Rajonal.

## **7. Metodatat e përdorura gjatë procesit të konsultimeve**

Sipas informacioneve të raportuara nga ministritë e linjës, Zyra e Kryeministrit, si dhe ato të nxjerra nga Platforma elektronike e konsultimeve publike, gjatë vitit 2023 janë publikuar 244 dokumente. Përveç publikimit në platformë, raportohet se gjatë procesit të konsultimeve publike morën pjesë gjithsej 2912 pjesëmarrës. Nga këta pjesëmarrës, u bënë gjithsej 2308 komente, qoftë përmes platformës, takimeve, grupeve të punës, apo edhe me shkrim. Konsiderohet se 925 komente janë pranuar plotësisht nga hartuesit e dokumenteve, 387 komente janë pranuar pjesërisht, ndërsa 912 komente janë refuzuar ose nuk janë pranuar nga institucionet hartuese.

Metodat e përdorura për konsultime - Gjatë vitit 2023, në platformën për konsultime me publikun janë publikuar 244 dokumente. Komente direkt në platformë janë dhënë për 193 dokumente. Shumica e dokumenteve të konsultuara në platformë janë gjithashtu konsultuar përmes komunikimit zyrtar dhe takimeve të punës, përfshi ato online, ku komentet janë dhënë edhe me shkrim, dhe të tjera.

## **8. Numri dhe statusi i komenteve**

Gjatë vitit 2023, në platformën për konsultimet me publikun janë publikuar 244 dokumente, ku për 237 prej tyre konsultimi është mbyllur më 31.12.2023.

Shumica e komenteve në platformë janë ofruar përmes dokumenteve të bashkëngjitura, të cilat e përmbajnë një numër më të madh të komenteve se sa ato që gjenerohen automatikisht në seksionin e statistikave. Numri i komenteve të llogaritura në këtë raport bazohet në informacionet zyrtare të ofruara nga koordinatorët e konsultimeve publike në ministrinë e caktuar. Është e rëndësishme të theksohet se pjesëmarrja e publikut në procesin e konsultimeve ndryshon nga ministria në ministri.

**Kualiteti i konsultimit** – Edhe këtë vit, metodologjia e përdorur për hartimin e këtij raporti dhe burimet e alokuara nuk e lejojnë vlerësimin e plotësimin të standardeve në aspektin kualitativ. Megjithatë, sipas informacioneve të ofruara përmes raportimit dhe atyre të publikuara, ka shumë shembuj të mirë të ministrive që kanë publikuar dhe konsultuar dokumente në platformë gjatë vitit 2023 sipas standardeve të rregullores.

| <b>Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas aktivitetit të bashkëpunëtorëve - 01.01.2023-31.12.2023</b> |  |  |               |   |
|---|--|--|---------------|---|
| <b>Institucioni</b>   | <b>Me komente (kontribute nga bashkëpunëtorët)</b> | <b>Pa komente (kontribute nga bashkëpunëtorët)</b> | <b>Totali</b> | <b>Ne përqindje ne raportin (Me komente / Pa komente)</b> |
| Zyra e Kryeministrit  | 3  | 14   | 17            | 17.65%  |

|  |               |               |            |        |
|--|---------------|---------------|------------|--------|
| Ministria e Kulturës Rinise dhe Sportit                          | 5             | 4             | 9          | 55.56% |
| Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | 2             | 35            | 37         | 5.41%  |
| Ministria e Industrisë, Ndermarresise dhe Tregtisë               | 2             | 19            | 21         | 9.52%  |
| Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal                     | 2             | 5             | 7          | 28.57% |
| Ministria e Mbrojtjes  | 0             | 15            | 15         | 0.00%  |
| Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve                     | 5             | 9             | 14         | 35.71% |
| Ministria e Shëndetësisë   | 2             | 9             | 11         | 18.18% |
| Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural            | 1             | 24            | 25         | 4.00%  |
| Ministria e Ekonomisë  | 1             | 2             | 3          | 33.33% |
| Ministria e Drejtësisë   | 7             | 29            | 36         | 19.44% |
| Ministria për Kthim dhe Komunitete                               | 0             | 0             | 0          | 0.00%  |
| Ministria e Punëve të Brendshme                                  | 4             | 20            | 24         | 16.67% |
| Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit      | 10            | 7             | 17         | 58.82% |
| Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës                      | 0             | 0             | 0          | 0.00%  |
| Ministria e Zhvillimit Rajonal                                   | 0             | 1             | 1          | 0.00%  |
| <b>Totali</b>  | <b>44</b>     | <b>193</b>    | <b>237</b> |        |
| <b>Ne përqindje</b>  | <b>18.57%</b> | <b>81.43%</b> |            |        |

*Tabela 4. Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas aktivitetit të bashkëpunëtorëve*

## **9. Përmbledhje për procesin e konsultimeve gjatë vitit 2023**

